



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:251590  
Datë: 05.03.2024  
Numri i dokumentit: 05412981

C.nr.1106/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. K. e S. me seli në Prishtinë, të sipas autorizimit e përfaqëson F. M.- P., kundër të paditurit I. R. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. I. R. nga Prishtina, me objekt të kontestit për rimbursim dëmi, jashtë seancës me datë 05.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia e paditëses B. K.e S. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit I. R. nga Prishtina, me objekt të kontestit për rimbursim dëmi, lënda sipas shenjës C.nr.1106/2018.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate me datën 05.04.2018, kundër të kundër të paditurit F. I. R. nga Prishtina, me objekt të kontestit për rimbursimin e dëmit.

Me datën 05.03.2024 gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, ku e autorizuar e paditëses e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje, përkatësisht për objektin e kontestit si në këtë lëndë është nxjerr aktgjykim nga Gjykata Themelore në Gjilan, (një kopje të aktgjykimit si pove ja ka dorëzuar Gjykatës) ku është e përfshirë edhe lartësia e dëmit prej 522.00 euro, andaj meqenëse paditësja ka një aktgjykim, ka deklaruar se e tërheqim padinë në këtë çështje kundër të paditurit I. R.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 266 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1106/2018 i datës 05.03.2024

Gjyqtari  
Përparim Zeka

**KËSHILLË JURDIKE**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.